



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:058619

Datë: 31.05.2019

Numri i dokumentit: 00340218

P.nr.493/16

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN- DEGA NË SUHAREKË, gjyqtari Qemail Suka, me pjesëmarrjen e Sek. Juridike Vjollca Haziraj, në lenden penale sipas P.Th. nga Prizreni aktakuzës, PPnr.2473/15 të datës 24.06.2016, ndaj të pandehurit A.H nga Prizreni, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në prezencë të prokurorit të PTH-së nga Prizreni B.S dhe të akuzuarit, në seancën e shqyrtimit fillestar, të mbajtur me dt.29.05.2019 mori, publikisht shpalli dhe me date 29.05.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri A.H i lindur më 02.01.1990, me numër, i biri i R.H dhe nënës H.H, e gjinisë Rr. , me vendbanim në Prizren Rr.D.R nr. 2, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, me parë i pa dënuar, shqiptar shtetas i R. se Kosovës.

ESHTE FAJTOR

Sepse prej datës se pa vërtetuar e gjer me datën 26.03.2015 ne Suharekë ne shtëpinë e tij familjare, me qëllim të ndërhyrjes se pa autorizuar ne njehsorin elektrik me nr. 35036875 pas shkyçjes se vere për shkak të borxhit, ka dëmtuar pllomben dhe është ri kyçur ne rrjet ne mënyrë ilegale, duke dëmtuar vulën zyrtare apo shenjën e ngjitur nga zyrtari i autorizuar i “Keds”, distrikti ne Prizren, ashtu qe ka bere ndërhyrjes te pa autorizuar ne pajisjet matëse elektrike.

Me këtë ka kryer veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 te KP.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 41, 43, 45, 73, 74, KP, si dhe nenit 414 te Kodit Penal, dhe nenit 359 par.1 dhe 2 dhe nenit 365 të KPP-së, i shqipton:

DENIM ME KUSHT

Duke i a caktuar dënimin me burgim prej 2 (dy) muajve, i cili dënimin nuk do të ekzekutohen nëse në kohën e verifikimit prej një viti i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

I akuzuari lirohet prej shpenzimeve te procedurës konform nenit 453 par. 4 te KPP-ës.

E dëmtuara;K.distrikti ne Prizren, udhëzohet qe kërkesën pasurore-juridike, ta realizoj ne kontest te rregullt civil.

A r s y e t i m

PTH. nga Prizreni me aktakuzën PPnr.2473/15 të datës 24.06.2016, ndaj të pandehurit A.H nga Prizreni, me numër personal për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, aktakuzën të cilën gjate seancës fillestare e ka përfaqësuar PTH ne Prizren Besim Susuri, i cili në tërësi ngel pranë të dhënave si në aktakuzë që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata ne shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e te akuzuarit ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i te akuzuarit i cili ne shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 te KPP ne shkresat e lendes nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë, pranimi i fajit nga ana e te akuzuarit, është bere vullnetarisht ne shqyrtimin fillestar, pranimi është mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, te cilat gjinden ne shkresat e lendes si dhe provat materiale te paraqitura ndaj te akuzuarit nga ana e PTH-se ne Prizren.

Gjykata po ashtu ne tërësi ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë ne shqyrtimin fillestare nga ana e te akuzuarit, është bërë ne pajtim me dispozitat e nenit 248 te KPP-se, nga se nuk ekziston ndonjë nga arsyet dhe kushtet për hedhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte te cilat i përmban aktakuza, Gjykata ka ardhur ne përfundim se me veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, andaj Gjykata ka vendosur te akuzuarin ta shpall fajtor dhe t'ia shqiptoi dënimin si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Gjykata gjate marrjes se vendimit mbi dënimin ka vlerësuar te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KP-se, te cilat ndikojnë ne lartësinë e dënimin.

Gjykata si rrethane lehtësuese mori për baze se i akuzuari ka pasur qëndrim korrekt ndaj Gjykatës, ka pranuar fajësinë ne mënyrë vullnetare, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, kurse rrethana posaçërisht renduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori ne kuptim te nenit 463 te KPP-se .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës e mori ne kuptim te nenit 452 par, 1 te KPP-ës.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKE

Gj y q t a r i
Qemail Suka

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtine, përmes kësaj Gjykate.